PROPOZIM-PLAN PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKAVE, PËR MENAXHIM EFIKAS TË ENERGJIS, NË NIVEL KOMUNAL

LIBRI I BARDHË

Ky dokument përshkruan përfitimet nga efikasiteti energjetik në përgjithësi për qeverisjen e mirë të një komune dhe ofron këshilla, zgjidhje dhe sugjerime që mund të zbatohen lehtësisht nga bashkësia lokale, të cilat do të ulin kostot e energjisë dhe ndikimin negativ në mjedis dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e besimit të qytetarëve në administratën komunale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Përmbajta

HYRJE 3

1. Metodologjia 4

2. Pasqyrë e kornizës ligjore 5

2.1. Pasqyrë e kornizës ligjore ndërkombëtare 5

2.2. Pasqyrë e ligjeve dhe strategjive kombëtare për efikasitet energjetik 7

3. Përfitimet e përmirësimit të efikasitetit energjetik në nivel të vetëqeverisjes lokale 9

3.1. Përfitimet socio-ekonomike 10

3.2. Përfitimet për mjedisin jetësorë 11

4. Krijimi i një sistemi për menaxhim efikas të energjisë në nivel komunal 12

4.1. Gjashtë hapa për të përmirësuar menaxhimin për efikasitet energjetik dhe qëndrueshmëri në nivel lokal 12

4.2. Krijimi i një ekipi/njësie organizative për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik 17

4.3. Karakteristikat për identifikimin e politikave dhe masave efektive dhe efikase për efikasitet energjetik 18

5. Praktika dhe shembuj të mirë të efikasitetit energjetik 20

Aneks 1 –Lista e dokumenteve dhe informatave të përdorura për përpunimin e analizës 23

Aneks 2 – Rezyme e masave të efikasitetit energjetik në sektorët e konsumit final të energjisë 25

Aneks 3 – Taksonomia e karakteristikave për planifikimin e masave dhe politikave efikase dhe efektive për efikasitet energjetik 27

Lista e fotografive

Foto 1: Efektet e mundshme pozitive nga avancimi i efiçiencës energjetike në komuna 4
Foto 2: Gjashtë hapa për kornizën strategjike dhe forcimin e praktikave komunale në lidhje me çështjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik 13
Foto 3: Shembuj dhe praktika të mira për nxitjen e efikasitetit energjetik, nga shtete të Unionit Evropian 20

Lista e tabelave

Tabela 1: Përfitimet socio-ekonomike nga investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel komunal 10
Tabela 2: Përfitimet mjedisore nga investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel komunal 11
Tabela 3: Literatura e shfrytëzuar dhe burimet e të dhënave 25
Tabela 4: Reyzme e masave për efikasitet energjetik 26
Tabela 5: Karakteristikat për krijimin e politikave dhe masave efektive dhe efikase për efikasitet energjetik 29

HYRJE

"Propozim-plani për përmirësimin e praktikave për menaxhim efikas energjetik në nivel komunal" (Libri i Bardhë), është përgatitur në kuadër të projektit "Menaxhimi për Komuna Efiçiente në Energji". Projekti implementohet nga Asociacioni i qytetarëve QENDRA RAJONALE PËR PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL Shkup (REFORD Shkup), në partneritet me Asociacionin e qytetarëve INSTITUT PËR POLITIKA TË GJELBËRTA DHE ZHVILLIM (IZPR Berovë), Shoqatën e Ambientalistëve NATURA Strugë dhe Asociacioni Qëndra për zhvillim të qëndrueshëm Dibër (CSCD Dibër). Projekti është i mbështetet nga granti për partneritet në veprim nga Civica Mobilitas (Nr. Ref. CM-PAG-01).

Qëllimi i Librit të Bardhë është të identifikojë dhe definoj politikat, masat, praktikat dhe shembujt e mirë, të cilat kanë dëshmuar një efekt pozitiv në përmirësimin e efikasitetit energjisë dhe përfitimeve nga e njëjta. Që ato të jenë funksionale dhe të zbatueshme, medoemos duhet që të përshtaten me kontekstin lokal, për të cilin autoritetet komunale duhet të përfshijnë qytetarët dhe bizneset në procesin e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave lokale.

Efikasiteti energjetik paraqet një aspekt i rëndësishëm dhe aktual të jetës dhe përditshmërisë sonë, si dhe i përpjekjes globale për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit. Përpjekja për përdorim më të mirë të energjisë dhe reduktimi i humbjeve të saj përfaqëson një sfidë dhe fokus gjithnjë e më të rëndësishëm, si për qytetarët dhe bizneset, ashtu edhe për politikëbërësit dhe vendimmarrësit në nivel qëndrorë dhe lokalë.

Efikasiteti energjetik nënkupton ngritjen dhe zhvillimin e sistemeve, infrastrukturës, instalimeve dhe ndërtesave që do të përdorin në mënyrë optimale energjinë, dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë jo vetëm në uljen e varësisë dhe nevojës për energji, por edhe në reduktimin e emetimeve të gazeve të dëmshme dhe efektin e ndryshimeve klimatike, me çka do të ketë një ndikim pozitiv në mjedis. Sipas kësaj, fokusi në efikaitetin energjetik nuk është vetvetiu ulje e kostove të energjisë, por edhe ulje e ndikimit negativ në mjedis, pa cenuar cilësinë e jetës së popullsisë.

Bota moderne po përballet me presion në rritje për të ndërmarrë masa dhe aktivitete që në njërën anë do të mundësojnë kosto optimale dhe shfrytëzim maksimal të burimeve dhe sasive të kufizuara të energjisë, dhe nga ana tjetër do të zvogëlojnë ndikimin e dëmshëm ndaj natyrës dhe shëndetit të njeriut. Sipas kësaj, nevoja për efikasitet energjetik është e shumëanshme –të kursehet në energji, të reduktohet ndikimi në klimë dhe mjedis, të zvogëlohet ndikimin në shëndetin e njeriut dhe të sigurohet qasje në energji me çmime të përballueshme, gjegjësisht të parandalohen pasojat e varfërisë energjetike. Efikasiteti në përdorimin e energjisë është i rëndësishëm nga aspekti ekologjike, por edhe nga aspekti ekonomike dhe sociale.




Foto 1: Efektet e mundshme pozitive nga avancimi i efiçiencës energjetike në komuna

Libri i Bardhë ofron një përshkrim të shkurtër të kontekstit nacional dhe lokal, duke marrë parasysh raportet komunale të përgatitura më parë dhe "Raportin përmbledhës për gjendjen e objekteve publike të menaxhuara nga komunat e Strugës, Dibrës, Berovës dhe Pehçevës, dhe kategorizimin e objekteve sipas për efikasitetit energjetik", definon praktikat, politikat dhe masat e mira dhe të zbatueshme në nivel komunal, që do të përmirësojnë qeverisjen dhe përgjegjësinë e komunave në drejtim të efikasitetit energjetik.

1. Metodologjia

Prodhimi i Librit të Bardhë bazohet në një kombinim të hulumtimeve dhe të dhënave dytësore dhe parësore.

Hulumtimi dhe analiza fillestare i referohet mbledhjes dhe shqyrtimit të burimeve të përshtatshme dytësore të informacionit, siç janë raportet dhe analizat ndërkombëtare, rishikimi i kornizës strategjike dhe ligjore për efikasitetin energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rishikimi i të dhënave dhe informacioneve në dispozicion në lidhje me praktikat energjetike në katër komunat e synuara (Berovë, Pehçevë, Dibër dhe Strugë), si dhe rishikim dhe analizë të dokumenteve të përgatitura paraprakisht në kuadër të projektit, përkatësisht raportet komunale dhe Raporti Përmbledhës. Lista e dokumenteve të analizuara dhe të marra parasysh gjatë përgatitjes së Librit të Bardhë jepet si Shtojca 1 e këtij dokumenti.

Identifikimi dhe analiza e dokumenteve dhe informacioneve të lartpërmendura mundësoi hartimin e situatës ekzistuese, por edhe përcaktimin e standardeve për politikat, por edhe përcaktimin e masave dhe praktikave të ardhshme lokale që do të përmirësonin procesin e menaxhimit komunal në aspekt të efiksitetit energjetik. Të dhënat dytësore të mundësuan:

- Përcaktimin e kornizës strategjike dhe ligjore për efikasitet energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe informata mbi kontekstin ligjor të efikasitetit energjetik,
- Vështrim mbi gjendjen aktuale, sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohen komunat në aspektin e efikasitetit të energjetik dhe
- Informata mbi nevojat aktuale, planet dhe mundësitë për përmirësimin e efikasitetit energjetik, të cilat mund të shërbejnë si bazë për propozimin e politikave, masave dhe aktiviteteve lokale për përmirësimin e menaxhimit me efikasitet të energjisë.

Nga diskutimi me ekspertët përgjegjës për realizimin e punëtorive dhe trajnimeve të planifikuara në kuadër të projektit, u identifikuan qëndrimet, opinionet, nevojat dhe pritshmëritë për zhvillimin e ardhshëm në nivel komunal, të cilat mund dhe duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të praktikave për avancimin e efikasitetit energjetik në nivel komunal.

Bazuar në të gjitha këto informacione dhe dokumente, janë përcaktuar propozimet për politika, masa, praktika dhe aktivitete të mira për përmirësimin e efikasitetit energjetik në komuna, të cilat janë paraqitur në Librin e Bardhë. Me këtë, libri i bardhë merr parasysh kontekstin dhe nevojat e përdoruesve final, duke u përpjekur të sigurojë bazën më të mirë të mundshme për zbatimin e suksesshëm të propozimeve të përcaktuara.

Rrjedhimisht, në procesin e përgatitjes së Librit të Bardhë, janë të angazhuara palët e ndryshme të interesuara dhe të prekura dhe i njëjti ofron një bazë për promovimin e praktikave për menaxhim efikas dhe të përgjegjshëm të burimeve energjetike në nivel komunal dhe do të jetë në dispozicion të publikut, për të shërbyer si një burim për komunat e tjera dhe palët e interesuara.

2. Pasqyrë e kornizës ligjore

Në këtë pjesë shpjegohet korniza ndërkombëtare ligjore dhe legjislacionin kombëtar dhe përcaktimet strategjike, të cilat ndikojnë në përcaktimin e politikave dhe udhëzimeve për efikasitetin energjetik.

2.1. Pasqyrë e kornizës ligjore ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare, protokollet dhe konventat e mëposhtme të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut të cilat u referohen ndryshimeve klimatike dhe angazhimit të vendit për reduktimin e efekteve dhe pasojave negative të ndryshimeve klimatike:

- ***Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike***– Qëllimi i Konventës është të sigurojë instrumente jurike që vendet nënshkruese do të mund të miratojnë, në mënyrë që të bashkangjiten dhe të kontribuojnë në përcaktimet e OKB-së për stabilizimin e përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë, të shkaktuara nga ndikimi dhe veprimet njerëzore. Konventa duhet ti lejojë kohë të mjaftueshme ekosistemit që të përshtatet me ndryshimet klimatike, duke garantuar kështu sigurinë në prodhimin e ushqimit dhe duke mundësuar vazhdimësinë e zhvillimit ekonomik, në mënyrë të qëndrueshme.

  Në aktivitetet e tyre për të arritur qëllimin e Konventës dhe për të zbatuar dispozitat e saj, vendet nënshkruese, duke përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndër të tjera, udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:
  - Mbrojtja e sistemit klimatik në interes të brezave aktualë dhe të ardhshëm, ku vendet e zhvilluara do të kenë rolin kryesor në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe pasojave negative të saj.

  - Duhet të merren parasysh nevojat specifike dhe rrethanat e veçanta të vendeve në zhvillim, veçanërisht atyre vendeve që janë më të ekspozuara ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike.
  - Vendet duhet të marrin masa për të parashikuar, parandaluar ose reduktuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet e saja negative. Politikat dhe masat për t'u përballë me ndryshimet klimatike duhet të jenë ekonomikisht efikase, për të siguruar përfitime globale me kostot më optimale.
  - Politikat dhe masat për mbrojtjen e sistemit klimatik nga ndikimi njerëzor duhet të përshtaten me kushtet specifike të çdo vendi dhe të integrohen në programet kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.
  - Masat për të luftuar ndryshimet klimatike duhet të mbështesin bashkëpunimin e hapur ekonomik ndërkombëtar, i cili do të çojë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

- ***Protokolli i Kiotos*** – Protokolli i Kiotos u pranua më 11 dhjetor 1997, hyri në fuqi më 16 shkurt 2005 dhe aktualisht ka 192 shtete nënshkruese. Republika e Maqedonisë së Veriut ka miratuar Protokollin e Kiotos nga viti 2004. Ky Protokoll operacionalizon Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe detyron vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim të kufizojnë dhe reduktojnë emetimet e gazeve serrë në përputhje me objektivat dakorduara. Vetë Konventa vetëm inkurajon vendet të miratojnë politika dhe masa për reduktimin e gazeve serrë, Protokolli i Kiotos përcakton detyrimet e duhura për vendet nënshkruese, bazuar në nivelet e emetimeve të gazeve serrë në atmosferë. Aneksi B i Protokollit të Kiotos përcakton objektiva të detyrueshëm për reduktimin e emetimeve për 37 vende të zhvilluara dhe në zhvillim, si dhe për Bashkimin Evropian. Në total, këto objektiva ofrojnë një reduktim mesatar prej 5% të emetimeve të gazeve serrë për periudhën 2008-2012, në krahasim me nivelet e vitit 1990.
- ***Marrëveshja e Parisit*** – Marrëveshja e Parisit është një marrëveshje ndërkombëtare juridiskisht e detyrueshme për ndryshimet klimatike. Ai u pranua nga 196 vende në Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në Paris, Francë, më 12 dhjetor 2015 dhe hyri në fuqi më 4 nëntor 2016. Marrëveshja e Parisit është ratifikuar në Republikën e Maqedonisë në vitin 2017. Qëllimi i saj kryesor është të mbajë "rritjen e temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet para-industriale" dhe të bëhen përpjekje "për të kufizuar rritjen e temperaturës nën 1.5°C mbi nivelet para-industriale" . Vitet e fundit, liderët botërorë kanë theksuar nevojën për të kufizuar rritjen e temperaturës globale në 1.5°C deri në fund të këtij shekulli. Kjo për shkak se Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike i Kombeve të Bashkuara njofton se tejkalimi i pragut prej 1.5°C rrezikon ekspozimin më të madh dhe më serioz ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë thatësirat më të shpeshta dhe më të rënda, valët e të nxehtit dhe reshjet e shumta. Për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1.5°C, emetimet e gazeve serrë duhet të arrijnë kulmin përpara vitit 2025 dhe të bien me 43% deri në vitin 2030
- ***Amendamenti i Dohas*** –Në takimin e tetë të Konferencës së shteteve që shërben si takim i palëve nënshkruesve të Protokollit të Kiotos, mbajtur në Doha, Katar, më 8 dhjetor 2012, vendet pranuan ndryshim të Protokollit, i njohur si "Amendamenti i Dohas", i cili u shpërnda më 21 dhjetor 2012 nga Sekretari i Kombeve të Bashkuara. Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar Amendamentin e Dohas në vitin 2019. Ndryshimet e parashikuara nga Amendamenti hyjnë në fuqi nga 31 Dhjetor 2020. Amendamenti i Dohas i referohet Protokollit të Kiotos dhe përcakton periudhën e dytë të angazhimit (2013-2020) për reduktimin e gazeve serrë për vendet nënshkruese.
- ***Amendamenti i Kigalit*** – Amendamenti i Kigalit në Protokollin e Montrealit është një marrëveshje ndërkombëtare për të reduktuar gradualisht përdorimin dhe prodhimin e

substancave të dëmshme që varfërojnë shtresën e ozonit. Paraqet një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme dhe Republika e Maqedonisë së Veriut ka miratuar ligjin për ratifikimin e saj në vitin 2020.

Këto marrëveshje ndërkombëtare vendosin bazën ligjore për detyrimet dhe rolin që merr shteti në luftimin e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike. Ato përfaqësojnë gjithashtu një bazë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe një angazhim për zgjidhjen e problemeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit, të cilat i detyrojnë vendet të zbatojnë masa dhe aktivitete specifike.

2.2. Pasqyrë e ligjeve dhe strategjive kombëtare për efikasitet energjetik

Çështja dhe sfida e përballjes me pasojat negative të ndryshimeve klimatike është një problem i shumëanëshëm, i cili përfshin aspekte të ndryshme, si energjia, efikasiteti energjetik, burimet e rinovueshme të energjisë, menaxhimi i mbetjeve, transporti, bujqësia e të tjera. Për nevojat e Librit të Bardhë, janë marrë parasysh vetëm ligjet dhe strategjitë kombëtare që lidhen me efikasitetin energjetik, dhe atë:

- ***Ligji për Efikasitet Energjetik*** – Ky ligj rregullon aspektet që kanë të bëjnë me përdorimin efikas të energjisë, politikat e efikasitetit energjetik dhe kompetencat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencisë së Energjisë në zbatimin e ligjit. Për më tepër, ai përcakton detyrimet e sektorit publik për sa i përket efikasitetit energjetik dhe konsumit të energjisë, skemës detyruese dhe masave alternative për efikasitetit energjetik, si dhe kontrollin energjetike të shitësve të mëdhenj. Ligji rregullon efikasitetit energjetik gjatë prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji, si dhe kryerjen e shërbimeve energjetike dhe mënyrat e financimit të masave për të mbështetur efikasitetit energjetik.
  Qëllimi i ligjit është të mundësojë zvogëlimin e nevojave për energji përmes përdorimit efikas të energjisë, arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm në energji, duke përfshirë reduktimin e konsumit të energjisë dhe ndikimet negative në mjedis, si dhe përmirësimin e karakteristikat energjetike të ndërtesave për rritjen e efiçencës energjetike. , për të rritur efiçencën e energjisë në sektorin publik, tregtarët e mëdhenj, sektorin e transportit dhe prodhimit, si dhe për të krijuar kushte për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe performancën e shërbimeve të energjisë për të rritur efikasitetin energjetik.
  Politikat e efiçiencës së energjisë parashikojnë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet konsumatorëve, prodhuesve, furnitorëve, tregtarëve dhe operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, ofruesve të shërbimeve të energjisë, organeve të administratës shtetërore dhe njësive të vetëqeverisjes lokale, me qëllim arritjen e qëllimeve në fushën e efikasitetit energjetik të parapara me ligj.
  Në përputhje me ligjin, Këshilli Komunal sjellë Program për Efikasitit Energjetik që përmban të dhëna për konsumin e energjisë në njësinë e vetëqeverisjes lokale, të agreguara dhe sipas sektorëve, analiza të masave dhe aktiviteteve të realizuara nga programi i mëparshëm, objektivat e efikasitetit së energjetik në niveli i njësive të vetëqeverisjes lokale, sipas sektorëve, masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e efikasitetit së energjetik, sipas sektorëve, afateve në të cilat duhet të zbatohen masat dhe aktivitetet individuale, si dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parapara dhe mënyra e sigurimit të tyre.
  Sipas dispozitave ligjore, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara të monitorojnë dhe menaxhojnë konsumin e energjisë në ndërtesat ose njësitë ndërtimore në të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në mënyrë që të arrihet kursimi i energjisë, si dhe të zbatojnë masat e

përcaktuara për përmirësimin e efikasitetit energjetik për të cilën janë përgjegjës sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitet Energjetik (PKVEE), programeve dhe planeve vjetore, si dhe të monitorojnë dhe menaxhojnë konsumin e energjisë në ndriçimin publik në mënyrë që të arrihet kursimi i energjisë.

- ***Rregullore për shënjimin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet që përdorin energji*** – Rregullorja përcakton produktet që duhet të shënjohen, mënyrën e shënjimit, mënyrën e përcaktimit të karakteristikave të produkteve dhe mënyrën e kontrollit të shënjimit. Qëllimi i rregullores është të krijojë një kornizë për harmonizimin e masave për informimin e përdoruesve të fundit, përmes shënjimit dhe sigurimit të informatave bazike për konsumin e energjisë, për t'i mundësuar përdoruesit të fundit të zgjedhin produkte më efikase në energji.
- ***Rregullore për kontrollin e energjisë*** – Kjo rregullore rregullon mënyrën e zbatimit të kontrollit të energjisë dhe mënyrën e vlerësimit të konsumit bazë të energjisë. Ai përcakton përmbajtjen dhe formën e raportit të kontrollit të energjisë dhe metodologjinë për matjen dhe verifikimin e kursimeve të energjisë. Me kontrollin e energjisë përcaktohet efikasiteti në përdorimit të energjisë, si dhe mundësia për reduktimin e konsumit të energjisë dhe arritjen e kursimeve. Kontrolli energjetik që kryhet mund të jetë i përgjithshëm ose i detajuar (investigativ) dhe kryhet nga një person juridik ose tregtar individual që ka licencë për të kryer kontrollin e energjisë.
- ***Strategjia për përmirësimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020*** – Qëllimi i strategjisë është zhvillimi i një kornize për adoptimin e përshpejtuar të praktikave për efikasitetit energjetik, në mënyrë të qëndrueshme, dhe nëpërmjet zbatimit të programeve dhe iniciativave që lidhen me reduktimin e varësisë nga importi, intensitetin e energjisë dhe përdorimin joproduktiv të energjisë. Strategjia identifikon potencialin për kursime me kosto efektive të energjisë në sektorët e banimit, komercial dhe të shërbimeve, industrisë dhe transportit.
- ***Plani i tretë i veprimit për efikasitet energjetik i Republikës së Maqedonisë, për periudhën 2016-2018*** – Detyrimi për përgatitjen e planit të tretë të veprimit për efiçencën e energjisë (APEE) rrjedh nga Ligji për Energjetikë. Dokumenti është përgatitur në bazë të kërkesave të nenit 14.1 të Direktivës 2006/32/EK të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi efikasitetin e konsumit final të energjisë dhe shërbimeve të energjisë, dhe është në përputhje me kërkesat e Direktivës për Efikasitet Energjetik (2012/27/ BE). Përmbajtja e dokumentit është përcaktuar në bazë të modelit të miratuar nga Sekretariati i Bashkësisë për Energji për nevojat e palëve kontraktuese. APEE e tretë përmban një vlerësim të zbatimit të APEE-së së dytë dhe masat e propozuara (Aneksi 2) për efikaitet sektoriale të energjisë, zbatimi i të cilave do të kontribuojë në reduktimin e konsumit final të energjisë, si dhe masat në anën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, të cilat duhet të kontribuojnë edhe në kursime të konsiderueshme të energjisë primare për periudhën 2016-2018.
- ***Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040*** – Kjo Strategji përcakton gjashtë qëllime strategjike për Republikën e Maqedonisë së Veriut, për periudhën deri në vitin 2040, të cilat janë në përputhje me kornizën energjetike të Bashkimit Evropian, me **vizion** për të ofruar një sistem energjetik *të besueshëm, efikas, ekologjik dhe konkurrues, i cili është të aftë për të mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit*. Kjo strategji integron aspekte të efikasitetit energjetik dhe një nga qëllimet strategjike është maksimizimi i kursimeve të energjisë, të cilat do të monitorohen përmes reduktimit % të konsumit primar dhe final të energjisë.

Nga rishikimi i kornizës ligjore kombëtare për efikasitetin energjetik, shihet se e njëjta bazohet në masë të madhe në dispozitat ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe ofron rregulla dhe standarde për përdorimin efikas të energjisë në sektorë të ndryshëm dhe përcakton kompetencat e aktorëve të ndryshëm, për sa i përket efikasitetit energjetik dhe synimeve për reduktimin e efekteve të gazeve serrë dhe ndikimit negativ të njeriut në mjedis, si rezultat i përdorimit joefikas të energjisë.

3. Përfitimet e përmirësimit të efikasitetit energjetik në nivel të vetëqeverisjes lokale

Investimi në efikasitetin energjetik vjen si rezultat i angazhimeve ndërkombëtare / globale për të reduktuar ndotjen dhe efektet e saj negative në ndryshimet klimatike dhe ndikimin në natyrë, prishjen e biodiversitetit dhe varfërimin e burimeve natyrore. Efektet e dëmshme të përdorimit të paarsyeshëm të energjisë nuk përfundojnë me natyrën dhe burimet e gjalla, por ndikojnë edhe në kushtet socio-ekonomike për jetën e njerëzve. Konsumimi i paarsyeshëm i energjisë ndikon në disponueshmërinë në sasi dhe çmim të energjisë, rrit cenueshmërinë e popullsisë së varfër dhe personave që jetojnë në rrezik social dhe ka një efekt të dëmshëm në shëndetin dhe cilësinë e jetës së njerëzve.

Marrëveshjet globale për klimën dhe objektivat për reduktimin e gazeve të dëmshme serrë synojnë të ndikojnë në nivelin e ndotjes dhe të kufizojnë ngrohjen e planetit Tokë. Për të arritur këto synime, të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë edhe komunat lokale, duhet të kontribuojnë dhe të luajnë rolin e tyre me përkushtim.

Legjislacioni dhe politikat kombëtare për efikasitetin energjetik i obligojnë komunat të zbatojnë masat e efikasitetit energjetik. Ndër të tjera, kjo përfshin detyrimet për të reduktuar konsumin e energjisë dhe për të kufizuar/kontrolluar emetimet e gazeve serrë të shkaktuara nga veprimet dhe ndikimet njerëzore.

Bashkimi Evropian dhe institucionet ndërkombëtare shpesh ofrojnë mbështetje financiare dhe inkurajojnë komunat të zbatojnë masa, projekte dhe aktivitete për të përmirësuar efikasitetin energjetik në nivel komunal.

Investimi në efikasitetin energjetik efekt pozitiv në cilësinë e ajrit, uljen e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Komunat kanë përgjegjësi për shëndetin dhe mirëqenien e banorëve të tyre dhe kjo është një tjetër nga përfitimet e përgjithshme me të cilat pushteti lokal mund të ndikojë dhe të kontribuojë në cilësinë e jetës në mjedisin lokal.

Së fundi, investimi në efikasitetin energjetik ndikon ndjeshëm në uljen e kostove pë energensë dhe krijon mundësinë e përdorimit të mjeteve në shërbime dhe projekte të tjera të rëndësishme për komunën dhe popullatën lokale.

Sipas kësaj, investimi në efikasitetin energjetik nga ana e komunave jo vetëm që i ndihmon ato të përmbushin detyrimet e tyre ligjore dhe morale ndaj qytetarëve, por edhe të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në komunitetin e tyre.

Në vazhdim të kësaj pjese shpjegohen më në detaje përfitimet e investimit dhe angazhimi për përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel të vetëqeverisjes lokale, nga pikëpamja ekonomiko-sociale dhe mjedisore.

3.1. Përfitimet socio-ekonomike

Investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik të komunave mund të ketë përfitime të rëndësishme socio-ekonomike, duke përfshirë:

	***Reduktimi i kostove për energensë***: Një nga përfitimet më të shpejta dhe më të dukshme të investimit në efikasitetin energjetik është ulja e kostove për energensë. Komunat janë përdorues të mëdhenj të energjisë për ndriçimin e hapësirave publike, ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave publike, transportin etj. Me përmirësimin e efikasitetit energjetik, kostot e energjisë mund të reduktohen ndjeshëm dhe mund të lirohen burime financiare për projekte zhvillimore dhe investime në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe fusha të tjera, të cilat do të kenë një ndikim pozitiv në jetesën e qytetarëve.
	***Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të rrezikut***: Përmirësimi i efikasitetit energjetik mund të ndihmojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së komunës dhe të zvogëlojë rreziqet e mungesës së energjisë - një sfidë bashkëkohore që prek jo vetëm Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe njerëzimin në nivel global. Përmirësimi i izolimeve dhe përdorimi efikas i energjisë mund të zvogëlojë rrezikun dhe pasojat për komunat dhe zhvillimin lokal të shkaktuar nga mungesa e energjisë me çmime të favorshme, si dhe rrezikun e kushteve të pafavorshme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.
	***Stimulimi i rritjes dhe zhvillimit të ekonomisë lokale***: Përmirësimi i efikasitetit energjetik mund të mbështesë rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë lokale. Duke u angazhuar dhe investuar në projekte për përmirësimin e efikasitetit energjetik, komuna krijon mundësi për kompanitë vendore për zbatimin e projektit dhe hap vende të reja pune. Një investim i tillë ka një ndikim të përgjithshëm pozitiv në komunë dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik lokal.
	***Rritja e vlerës së pasurive të patundshme***: Duke investuar në përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave publike dhe infrastrukturës, komunat mund të ndikojnë në rritjen e vlerës së pasurive të patundshme. Izolimi dhe pajisja më e mirë për efikasitetit energjetik i bëjnë ndërtesat publike më tërheqëse për investitorët dhe popullsinë vendase.
	***Përmirësimi i kushteve të punës për administratën lokale:*** Efikasiteti energjetik përmirëson komoditetin dhe cilësinë e kushteve të punës për punonjësit e administratës lokale. Përveç kësaj, investimet në përmirësimin e efikasitetit energjetik të objekteve publike nëpër komuna ndikojnë gjithashtu në atraktivitetin e komunës si vend për të jetuar.

Tabela 1: Përfitimet socio-ekonomike nga investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel komunal

Rrjedhimisht, investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik ka përfitime të konsiderueshme socio-ekonomike afatgjata për komunat, duke përfshirë uljen e shpenzimeve, përmirësimin e qëndrueshmërisë, kursimet në fondet publike, rritjen ekonomike dhe më shumë. E gjithë kjo ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës lokale dhe rrit kapacitetin konkurrues të komunës.

3.2. Përfitimet për mjedisin jetësorë

Investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik nga vetëqeverisja lokale mund të ketë përfitime të konsiderueshme për mjedisin jetësorë, ndër të cilat disa nga më të rëndësishmet janë:


	***Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë***: Me përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesat komunale dhe infrastrukturën publike mund të kontribuojë ndjeshëm në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë si CO2, CH4 dhe N2O. Kjo ndihmon në reduktimin e ngrohjes globale dhe parandalimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike
	***Përdorimi efikas dhe kursimi i burimeve natyrore***: Përmirësimi i efikasitetit energjetik nënkupton konsum më të ulët të energjisë, që nga ana tjetër nënkupton përdorimin e reduktuar të burimeve natyrore siç janë karburantet.
	***Mbrojtjen e ujrave dhe resurseve ujore***: Sistemet energjetike, veçanërisht ato për prodhimin e energjisë, shpesh përdorin sasi të mëdha uji për ftohje dhe qëllime të tjera. Duke rritur efikasitetin energjetik dhe duke reduktuar nevojën për energji, ulet edhe nevoja për ujë, duke ruajtur kështu resurset ujore.
	***Ruajtja e diversitetit biologjik***: Investimi në efikasitetin energjetik mund të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit dhe ujit, gjë që ndikon në cilësinë e mjedisit dhe biodiversitetin.
	***Cilësi më e mirë e ajrit:*** Sistemet energjetike janë një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit. Përmirësimi i efikasitetit energjetik mund të reduktojë emetimet e ndotësve, si dhe të kontribuojë në cilësi më të mirë të ajrit dhe shëndet për banorët.
	***Reduktimi i materjeve mbetëse:*** Përmirësimi i efikasitetit të proceseve të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve mund të zvogëlojë sasinë e kimikateve dhe mbetjeve të rrezikshme që përfundojnë në natyrë, duke reduktuar kështu ndotjen e tokës dhe ujit.

Tabela 1: Përfitimet mjedisore nga investimi në përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel komunal

Ruajtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë dy nga sfidat më të mëdha të shoqërisë moderne. Investimi në efikasitetin energjetik luan një rol të rëndësishëm në arritjen e këtyre synimeve globale.

4. Krijimi i një sistemi për menaxhim efikas të energjisë në nivel komunal

4.1. Gjashtë hapa për të përmirësuar menaxhimin për efikasitet energjetik dhe qëndrueshmëri në nivel lokal

Megjithëse efikasiteti dhe qëndrueshmëria energjetike si tema janë të përfaqësuara gjithnjë e më shumë në botën tonë bashkëkohore, përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe udhëheqësit në sektorin publik po përballen gjithnjë e më shumë me një mungesë udhëzimesh konkrete dhe praktike për rolin dhe ndikimin e tyre në këto përpjekje.

Të vetëdijshëm për rëndësinë e çështjeve si çmimi i energjisë, mbrojtja e klimës dhe reduktimi i efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, si dhe sfida të tjera të ngjashme, kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e këshillave në komuna janë përballë sfidës së zgjidhjes së këtyre problemeve duke gjetur mjete për zbatimin e programeve inovative dhe moderne për efikasitet energjetik. Ndonëse autoritetet vendore e kuptojnë nevojën dhe detyrimet për t'iu përgjigjur këtyre sfidave që prekin çështjen e qëndrueshmërisë dhe rezistueshmërisë, megjithatë, mjaft shpesh, mungon përvoja, praktikat e mira dhe ekspertiza që janë të nevojshme për t'iu përgjigjur këtyre çështjeve. Kjo në fakt krijon një hendek midis vullnetit politik për t'iu përgjigjur nevojës për efikasitet energjetik, në krahasim me performancën dhe praktikën në lidhje me të. Së fundi, si rrjedhojë, kemi ligje dhe zgjidhje ligjore, kemi një nevojë dhe vullnet të shprehur qartë politik dhe qytetar dhe mungesë në zbatimin efikas dhe efektiv.

Sfidat energjetike tashmë janë një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen institucionet që menaxhojnë fondet dhe buxhetet publike, jo vetëm në planin dhe ndarjen e fondeve për këtë qëllim, por edhe në aspektin e zbatimit të programeve dhe detyrimeve që lidhen me efikasitetin energjetik. Ka ikur koha kur dikutimi dhe debati rreth energjisë dhe qëndrueshmërisë kufizohej në nivel nacional dhe shtetëror. Sot, autoritetet lokale pritet të marrin një rol aktiv në zbatimin e këtyre përpjekjeve dhe të kontribuojnë në zgjidhjen e çështjeve të energjisë, në funksion të përmirësimit të programeve aktuale dhe në drejtim të mirëqeverisjes. Për dallim nga koha kur programet mjedisore shiheshin si tema konkurruese në raport me prioritetet e tjera në politikë, sot qëndrueshmëria njihet si qëllim në vetvete dhe si një mënyrë e mundshme për të përmirësuar programet publike dhe qeverisjen.

Edhe pse qëndrueshmëria dhe efikasiteti energjetik janë tema të njohura në mesin e qytetarëve, mbështetja e tyre mund të bazohet në koncepte dhe pikëpamje abstrakte se çfarë është qëndrueshmëria dhe efikasiteti energjetik, si duket zbatimi me sukses dhe cilat janë efektet e menjëhershme dhe ndikimet afatgjata të investimit në të njëjtat.

Nga autoritetet lokale pritet të trajtojnë dhe menaxhojnë me sukses çështjen dhe detyrimet që dalin në lidhje me efikasitetin energjetik, aq më tepër po të kemi parasysh se ato janë, ndër të tjera, një masë e qeverisjes së përgjegjshme, duke pasur parasysh mungesën e energjinë, koston e energjisë, kërkesat për mbrojtjen e klimës dhe sfida të tjera të ngjashme. Për qytetarët, vetëqeverisja lokale është një nga palët kryesore të tanguara që duhet të angazhohet dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në zgjidhjen e këtyre sfidave duke prezantuar programe, masa dhe zgjidhje inovative për efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen nga ndryshimet klimatike. Megjithatë, edhe pse autoritetet lokale duken të gatshme për t'iu përgjigjur qëndrueshmërisë së frontit politik, një sfidë serioze shfaqet për sa i përket burimeve (materiale, financiare, teknike dhe njerëzore) për realizimin e këtyre angazhimeve.

Duke marrë parasysh që efikasiteti energjetik paraqet një sfidë serioze dhe komplekse, me ndikim dhe pasoja të gjera, autoritetet vendore duhet të demonstrojnë një vullnet dhe përkushtim të qartë si për krijimin ashtu edhe për zbatimin e programeve dhe politikave për efikasitet energjetik.

Reduktimi ose të paktën optimizimi i konsumit të energjisë, rritja e pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e rinovueshme dhe zvogëlimi i emetimeve të gazeve serrë janë pjesë e masave dhe aktiviteteve për të cilat autoritetet lokale duhet të ofrojnë resurse, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave globale dhe prioriteteve nacionale në lidhje me qëndrueshmërinë dhe efikasitetin energjetik. Rrjedhimisht, roli i autoriteteve lokale në fushën e energjisë dhe ndryshimeve klimatike është i madh dhe domethënës, dhe në të ardhmen, përmes bashkëpunimit me qytetarët dhe sektorin e biznesit, ato duhet të marrin përparësi ndaj qeverisë, përsa i përket inovacioneve për qëndrueshmëri krijim dhe zbatimin e politikave dhe masave të duhura.

komunat kanë rol kyç në çështjen e qëndrueshmërisë dhe efiksitetit energjetik, jo vetëm si aktor që ndikon në ndryshimet klimatike, por edhe si aktor që ka detyrimin të ndikojë në kostot e energjisë duke u kujdesur dhe ruajtur mirëqenien e qytetarëve. Së bashku, autoritetet lokale mund të kontribuojnë në arritjen e synimeve kombëtare për efikasitet energjtik dhe reduktimin e ndikimeve të dëmshme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, duke reduktuar emetimet, në kuadër të kompetencave dhe detyrimeve të tyre.

Edhe pse nuk ka një qasje universale programore ose mjet politikash të përshtatshme që i përshtaten çdo komuniteti, në vijim përshkruhen gjashtë hapa që mund të ndiqen dhe zbatohen nga pushtetet lokale për të përshtatur në mënyrë strategjike çështjen e menaxhimit me efikasitetin energjetik.




Foto 1: Gjashtë hapa për kornizën strategjike dhe forcimin e praktikave komunale në lidhje me çështjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik

- ***Programi për Efikasitet Energetik – Formulimi i qëllimeve strategjike dhe treguesve për suksesshmëri të strategjive lokale për menaxhim me efikasitetin energjetik***

Hapi i parë përfshin përgatitjen ose përditësimin e Programit për Efikasitet Energjetik me qëllime specifike dhe masa të suksesshmëris. Programi i efikasitetit energjetik është një dokument bazë që jep

udhëzimet dhe synimet që pushteti lokal planifikon të arrijë në drejtim të efikasitetit energjetik, si dhe përcakton mënyrën e matjes të së njëjtëve, nëpërmjet treguesve të qartë dhe specifikë. Programi duhet të përfshijë afate kohore për reduktimin e emetimeve, objektiva të qarta për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, vlerësime kosto-përfitim dhe masa të llogaridhënies. Ky dokument është një udhëzues strategjik për pushtetin lokal dhe të punësuarit në sektorit publik për të reduktuar emetimet dhe për të kursyer energji. Është thelbësore që palët kryesore të interesuara, duke përfshirë politikëbërësit dhe administratorët, të angazhohen për një rrugë të unifikuar drejt qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të energjisë

Programi për efikasitetit energjetik duhet të lidhet me qëllimet tjera strategjike për zhvillimin e komunës, p.sh. të kontribuojë në planin për zhvillim ekonomik lokal, por edhe me qëllime të tjera strategjike të qeverisë, siç janë planet për zhvillim financiar dhe ekonomik. Qëllimi është krijimi i një udhërrëfyesi për efikasitetit më të madhe energjetike dhe mbrojtje dhe parandalim të pasojave të ndryshimeve klimatike, përmes masave dhe aktiviteteve transparente, të cilat do të ofrojnë rezultate të matshme dhe përfitime konkrete. Fatkeqësisht, siç shihet nga raporti përmbledhës, komunat nuk i përditësojnë rregullisht Programet për Efikasitetit Energjetik dhe nuk raportojnë rregullisht për zbatimin e tyre.

- ***Inkurajimi i qytetarëve dhe palëve të interesuara për të marrë pjesë në vendimet për planifikimin eprojekteve për efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e energjisë***

Pushteti vendor duhet të inkurajojë dhe promovojë përfshirjen e qytetarëve dhe të palëve të interesuara në vendimet për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e energjisë. Kjo është thelbësore në fazën e zbatimit, sepse ulja e konsumit të energjisë dhe gazeve serrë kërkon ndryshime në sjelljen e punonjësve, por edhe të qytetarëve dhe të komunitetit në tërësi. Menaxhimi nga pala e kërkesës duhet të marrë parasysh përdoruesit përfundimtarë, pra qytetarët dhe sektorin e biznesit. Progresi në përmirësimin e efikasitetit të energjisë mund të pengohet dhe ngadalësohet nga mungesa e të kuptuarit, informacioni i pamjaftueshëm dhe stimujt e pamjaftueshëm për qytetarët dhe sektorin e biznesit.

Për të siguruar besueshmërinë e procesit të planifikimit, është thelbësore përfshirja e palëve të ndryshme të interesit – palëve të prekura dhe palëve të interesuara, por edhe zyrtarëve të zgjedhur, zyrtarëve të emëruar, drejtuesve të departamenteve, personelit teknik dhe aktorëve të ndryshëm të jashtëm, si sektori civil, komunitetit të biznesit dhe grupeve të qytetarëve të interesuar. Suksesi i përpjekjeve për qëndrueshmëri dhe arritja e efikasitetit energjetik varet nga aftësia e drejtuesve të pushtetit lokal për të marrë mbështetje të gjerë për nismat e tyre.

Kompleksiteti i çështjeve së qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik paraqet një sfidë për personat udhëheqës në sektorit publik, duke kërkuar që ata të marrin në konsideratë dhe të përshtaten me më tepër interesa të ndryshme (dhe nganjëherë kontradiktore). Prandaj, është e rëndësishme që përpjekjet për qëndrueshmërinë dhe efikasitetit energjetik të marrin parasysh kontekstin lokal dhe të synojnë masat, aktivitetet dhe politikat që janë të rëndësishme për komunitetin lokal dhe palët e interesuara, duke i ndihmuar këto palë të prekura të kuptojnë rolin e autoriteteve lokale brenda strategjive më të gjera për mbrojtjen e klimës dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

- ***Përfshirja e palëve të prekura dhe të interesuara dhe vendosja e bashkëpunimit me sektorin civil, për ndarjen dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, si dhe për realizimin e nismave dhe projekteve të përbashkëta.***

Hapi i tretë përfshin bashkëpunimin proaktiv dhe përfshirjen e palëve të прекура dhe palëve të interesuara nga komuniteti lokal në procesin e të mësuarit dhe shkëmbimit të informacionit mbi temën e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjтик. Ky dhe hapi i mëparshëm janë të lidhur ngushtë. Qëllimi është që pushteti lokal të mundësoj mësim nga njëri-tjetri duke shkëmbyer informacion, njohuri, praktika të mira dhe mësime të nxjerra mbi këtë temë, me përfaqësuesit e interesuar nga komuniteti lokal. Këto angazhime nga autoritetet komunale janë një hap kyç për të siguruar që politikat dhe masat për efikasitet dhe qëndrueshmëri energjetike të mos jenë të rastësishme dhe të kenë një ndikim të rëndësishëm në komunitetin lokal.

Bashkëpunimi me qeveritë e tjera vendore, si dhe me palët e interesuara shtetërore dhe rajonale, është gjithashtu thelbësor për të promovuar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e energjisë. Nivele të ndryshme të qeverisjes plotësojnë njëri-tjetrin në përpjekjet e tyre në këtë drejtim. Për më tepër, koordinimi me qytetarët dhe palët e prekuar në nivel lokal është i rëndësishëm për të inkurajuar veprimin lokal për çështjet e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik. Organizatat mjedisore kanë një rol të rëndësishëm në mobilizimin e aktivistëve mjedisorë lokalë për të punuar me pushtetin lokal për këto çështje aktuale.

Pushteti lokal duhet të zgjerojë procesin e bashkëpunimit për të gjetur një mënyrë për të ndërtuar partneritete strategjike dhe për të realizuar projekte të përbashkëta për asistencë teknike apo lloje të tjera mbështetjeje, për të arritur detyrimet e marra për efikasitet energjetik.

- ***Krijimi i një ekipi multidisiplinar për qëndrueshmëri, i cili gjithashtu do të mbulojë temën e efikasitetit energjetik***

Ky hap, në varësi të madhësisë së komunës, propozon ngritjen e një departamenti, sektori apo ekipi përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikasitet energjetik që do ti koordinoj përpjekjet e pushtetit vendor në lidhje me këto çështje dhe do të monitorojë ecurinë në realizim. Kjo nënkupton që pushteti lokal duhet të ndajë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik. Financimi i veçuar do të mundësojë institucionalizimin e përpjekjeve për menaxhim të efikasitetit energjetik dhe do të ofrojë mbështetje sistematike dhe të qëndrueshme për këtë çështje.

Kur funksionet e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik janë pjesë e departamenteve ekzistuese me qëllime më të gjera si planifikimi ose zhvillimi i komunitetit, konkurrenca për burime mund të çojë në një prioritet të ulët për çështjet e energjisë. Kjo është arsyeja pse krijimi i një ekipi të pavarur të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik me ekspertizë, burime dhe kompetenca profesionale është thelbësor për t'i dhënë përparësi suksesit të programit të efikasitetit energjetik dhe programeve dhe planeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Për komunat me një ekip dhe burime të dedikuara, matja e performancës është një funksion kyç. Treguesit specifikë, si konsumi total i energjisë dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, e bëjnë qëndrueshmërinë më të kuptueshme për qytetarët. Treguesit duhet të ofrojnë qëllime të qarta sasiore e që janë lehtësisht të matshme.

Udhëzimet formale dhe joformale për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial janë të nevojshme, pasi projektet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe efikasitetit energjetik shpesh plotësojnë aktivitetet aktuale ose mund të bien ndesh me to. Centralizimi i çështjeve dhe përgjegjësive në një ekip të përkushtuar të qëndrueshmërisë dhe efikasitet energjetik ndihmon në zgjidhjen e konflikteve të tilla dhe lejon harmonizimin e programeve dhe planeve të ndryshme zhvillimore në nivel lokal, duke rezultuar në efekte pozitive përcjellëse si reduktimi i emetimeve, bllokimeve dhe ndotjes.

- ***Kombinimi i aspekteve dhe prioriteteve të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik me programet dhe shërbimet e zhvillimit ekonomik lokal***

Ky hap rekomandon që hartimi i programeve të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike të sigurojë që ato të plotësojnë aktivitetet thelbësore të pushtetit lokal, si përdorimi i tokës, ofrimi i shërbimeve dhe promovimi i zhvillimit ekonomik lokal. Pushtetet lokale mund të reduktojnë emetimet e karbonit duke adoptuar një qasje të zgjuar për rritje, përmes së cilës, në aktivitetet dhe funksionimin e përditshëm të komunës dhe ndërmarrjeve publike që ajo menaxhon, do të përpiqen të reduktojnë emetimet e gazeve serrë dhe përdorimin e energjisë. Këto iniciativa ofrojnë disa avantazhe, duke përfshirë kursimin e kostos, ruajtjen e hapësirës së gjelbër, reduktimin e ndikimeve të dëmshme mjedisore dhe mundësinë për të përmirësuar përpjekjet në zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin e rritjes.

Menaxhimi strategjik i programeve të efikasitetit energjetik mund të adresojë një sërë nevojash lokale dhe potencialisht të arrijë efikasitet në nivele të shumta, jo vetëm nëpërmjet kursimit të energjisë. Në kundërshtim me bendjen se politikat e qëndrueshmërisë nuk janë ekonomikisht të qëndrueshme, përpjekjet për reduktimin e efikasitetit energjetik dhe gazit serrë shpesh çojnë në kursime të drejtpërdrejta të kostove operacionale. Këto përpjekje kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e performancës së programeve dhe strategjive të tjera të zhvillimit lokal.

Autoritetet e qytetit kanë një sërë përgjegjësish, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve, promovimin e zhvillimit ekonomik, zhvillimin rregullator, menaxhimin e taksave dhe më shumë. Programet e qëndrueshmërisë duhet të përshtaten për t'i plotësuar këto funksione përmes koordinimit dhe harmonizimit me qëllimet e qëndrueshmërisë. Komunitetet e qëndrueshme kanë potencialin për të tërhequr investime afariste, fuqi punëtore të kualifikuar dhe mundësi që lidhen me industritë e energjisë së gjelbër dhe të pastër.

Duke e inkuadruar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e energjisë si çështje lokale që kërkojnë veprim lokal, politikëbërësit mund të kapërcejnë barrierat historike për adresimin e këtyre çështjeve.

- ***Udhëheqja përmes shembullit - rritja e iniciativave dhe praktikave të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energetik në kuadër të aktiviteteve dhe funksionimit të përditshëm të vetëqeverisjes lokale***

Hapi i fundit inkurajon qeveritë lokale të udhëheqin me shembull duke u fokusuar fillimisht në aktivitetet dhe operacionet e brendshme përpara se të zgjerojnë përpjekjet në komunitet. Duke arritur kursime në kosto nëpërmjet efikasitetit në përdorimin e tyre të energjisë, qeveritë vendore mund të gjenerojnë mbështetje më të gjerë për iniciativat e qëndrueshmërisë. Investimet në efikasitetin energjetik shpesh japin kthime të shpejta, duke kundërshtuar argumentet se qëllimet mjedisore dhe zhvillimi ekonomik janë në konflikt

Qëndrueshmëria mund të çojë në ndryshime dramatike në politika, por komunat nuk janë ende të përkushtuara sa duhet dhe nuk po përdorin potencialin e tyre të plotë për të reduktuar konsumin e karbonit dhe energjisë. Përderisa shumë komuna shprehin mbështetje për mbrojtjen e klimës dhe qëndrueshmërinë e energjisë, përpjekjet e tyre shpesh janë të kufizuara , nuk janë të zgjeruara dhe nuk e përfshinë komunitetin më të gjerë.

Fillimisht, mjafton që autoritetet lokale regullisht të përditësojnë dhe monitorojnë progresin në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe rezultateve të Programeve për Efikasitet Energjetik, si dhe të raportojnë në lidhje me të. Kursimet në shpenzimet për tatimpaguesit që vijnë nga konsumi i reduktuar i energjisë mund të ndihmojnë në kapërcimin e kundërshtimit ndaj nismave të qëndrueshmërisë. Pasi

përpjekjet e brendshme të provohen se janë të besueshme dhe efektive, hapi tjetër është zgjerimi i tyr për të reduktuar emetimet e karbonit në komunitetin e gjerë, duke i bërë angazhimet e energjisë një pjesë të përhershme të sistemit të menaxhimit.

Suksesi i përpjekjeve lokale në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme varet nga politikat e qeverisë që përputhen me qëllimet lokale, kuptimi administrativ dhe menaxherial i këtyre çështjeve dhe kapaciteti i autoriteteve lokale dhe administratës publike për t'i zbatuar ato.

4.2. Krijimi i një ekipi/njësie organizative për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik

Një nga hapat e elaboruar më parë për përmirësimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike në nivel të vetëqeverisjes lokale sugjeron krijimin e një ekipi ose njësie organizative të specializuar brenda komunës, e cila do të ketë buxhet adekuat dhe mjete teknike për këtë qëllim.

Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së energjisë është i arritshëm duke vendosur praktika dhe procese efektive të menaxhimit të energjisë, të cilat mund të zbatohen nga çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, funksioni apo misioni i saj, për sa kohë që ka një angazhim për të. Udhëzimet për menaxhim të efikasitetit energjetik të paraqitura në këtë raport ndjekin shtatë hapat kryesorë të përshkruar në dokumentin Udhëzues për Menaxhimin e Energjisë ENERGY STAR[1].

Udhëzuesi përcakton 7 hapa, dhe atë:

1. ***Përkushtimi*** – ky hap nënkupton krijimin e një ekipi për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik, dhe përcaktimin e një Programi dhe synimet për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik, programi, ndër të tjera, duhet të sigurojë një qëllim afatgjatë të përcaktuar qartë, të krijojë një sistem përgjegjësie dhe detyrimeve të qarta, të sigurojë progres të vazhdueshëm dhe të ofrojë dhe promovojë qëllime që janë me rëndësi për komunitetin lokal dhe janë relevante për kontekstin lokal.
2. ***Vlerësimi i punës*** – për të matur progresin në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe rezultateve, duhet të përcaktohen treguesit bazë, si dhe synimet që duhet të arrihen në një periudhë të caktuar kohore. Ekipi duhet të trajnohet se si, sa shpesh dhe nga kush të mbledhë të dhëna dhe si t'i analizojë dhe prezantojë ato në një formë të kuptueshme, të krahasueshme dhe të qartë.
3. ***Përcaktimi i qëllimeve*** – Përcaktimi i qëllimeve është i rëndësishëm, për të siguruar zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm, por edhe një drejtim të qartë se çfarë synon komuniteti dhe cilat janë prioritetet në drejtim të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik. Objektivat duhet të jenë të qarta, të kufizuara në një periudhë të caktuar kohore, në të cilën ato planifikohen të arrihen, dhe të ofrojnë vlerësime të qarta dhe një përshkrim të ndikimit dhe rezultatit që do të arrihej me zbatimin e të njëjtave. Gjithashtu, synimet duhet të lidhen me qëllimet e përgjithshme për zhvillimin ekonomik lokal, por edhe të jenë në përputhje me politikat dhe prioritetet nacionale për qëndrueshmëri dhe efikasitet energjetik.
4. ***Përgatitja e një plani aktivitetesh*** – Plani i veprimit duhet të përcaktojë qartë se me cilat aktivitete dhe detyra qeveria vendore planifikon të realizojë rezultatet dhe synimet e planifikuara për efiçencën dhe qëndrueshmërinë e energjisë. Për këtë qëllim, krahas aktiviteteve, duhet të përcaktohen qartë afatet e zbatimit të tyre, buxheti i kërkuar, si dhe personat përgjegjës dhe/ose institucionet.Plani i veprimit duhet të përcaktojë qartë se me cilat aktivitete dhe detyra pushteti lokal planifikon të realizojë rezultatet dhe synimet e planifikuara

[1] Burim: https://www.energystar.gov/buildings/tools-and-resources/energy-star-guidelines-energy-management

për efikasitet dhe qëndrueshmëri energjetik. Për këtë qëllim, krahas aktiviteteve, duhet të përcaktohen qartë afatet e zbatimit të tyre, buxheti i kërkuar, si dhe personat përgjegjës dhe/ose institucionet.

5. ***Zbatimi i planit*** – Zbatimi i planit/programit për efikasitet dhe qëndrueshmëri energjetike, siç u shpjegua më parë, është i rëndësishëm që të përfshi edhe komunitetin lokal. Kjo do të thotë se zbatimi duhet të përmbajë një plan për komunikim me komunitetin, një plan dhe aktivitete për forcimin e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me këto çështje dhe tema, si dhe të ofrojë mundësi për ngritjen e kapaciteteve, por edhe masa dhe aktivitete specifike përmes së cilës do të motivohej dhe inkurajohej komuniteti lokal dhe afarist për të avancuar praktikat dhe angazhimet për menaxhim efikas të energjisë dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm
6. ***Monitorimi dhe matja e progresit*** – Ky hap ka të bëjë me monitorimin dhe matjen e progresit dhe arritjeve të programit të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike. Monitorimi dhe matja duhet të japin informacion nëse dhe në çfarë mase janë realizuar aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara dhe sa të rëndësishme janë ato, si kontribuojnë në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të përcaktuara. Nëse jo, bazuar në rezultatet e monitorimit, është e nevojshme të rregullohet dhe rishikohet plani i aktiviteteve.
7. ***Njohja dhe promovimi i përfitimeve dhe arritjeve*** – Ekipi përgjegjës për suksesin dhe arritjet në drejtim të promovimit të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike duhet të marrë njohjen e duhur për punën e tyre dhe rezultatet e tyre duhet të fitojnë dukshmëri para komunitetit të gjerë, pasi kjo është çelësi për ruajtjen e motivimit dhe përkushtimit ndaj arritjeve në këtë pjesë.

Nga kjo shihet se për të pasur sukses në procesin e menaxhimit dhe arritjen e progresit të vazhdueshëm në drejtim të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike, këto çështje duhet të trajtohen në mënyrë sistematike, me qëllime qartë të përcaktuara dhe me përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara qartë, progresi i të cilit do të monitorohet dhe promovohet rregullisht

4.3. Karakteristikat për identifikimin e politikave dhe masave efektive dhe efikase për efikasitet energjetik

Deri më tani, rekomandimet e politikave për efikasitet energjetik janë organizuar kryesisht sipas sektorëve, duke u fokusuar në qasjet efektive dhe të realizueshme në sektorët e vendosur. Këto rekomandime zakonisht ofrojnë udhëzime të përgjithshme për krijimin e politikave efikasitet energjetik dhe shpesh mund të jenë të përgjithshme, pa masa, aktivitete dhe programe specifike. Megjithatë, është krijuar mjaft përvojë gjatë viteve për të identifikuar politikat dhe masat të cilat janë efektive dhe efikase.

Për të identifikuar politikat efektive, është e nevojshme të instalohet e ashtuquajturat taksonomi ose përmbledhje atributesh, që do të ndihmojë në identifikimin e politikave më efektive dhe ekonomikisht efikase. Në Shtojcë 3 është dhënë një listë e karakteristikave që mund të përdoren nga komunat për të planifikuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e politikave për efikasitetin energjetik.

Katër karakteristika kryesore dallohen si shumë relevante kur përcaktohen politikat, masat dhe aktivitetet për promovimin e efikasitetit energjetik:

1. ***Mundësi për të gjeneruar përfitime dhe rezultate të rëndësishme:*** Politikat dhe masat duhet të çojnë në reduktimin e ndjeshëm të kërkesës për energji, si dhe të ofrojnë përfitime të shumta të rëndësishme dhe të matshme.
2. ***Masat dhe politikat e planifikuara në nivel lokal duhet të kenë komplementaritet, sinergji dhe integrim:*** do të thotë të jetë në gjendje të përputhet lehtësisht me përpjekjet nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare dhe të kontribuojë qartë në arritjen e atyre synimeve më të larta strategjike dhe globale. Politikat dhe masat lokale të efikasitetit energjetik duhet të jenë në gjendje të zbatohen rrjedhshëm, të plotësojnë politikat ekzistuese dhe të mundësojnë maksimizimin e ndikimit të tyre.
3. ***Përafrimi politik, qeverisja e mirë, llogaridhënia dhe transparenca:*** në planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe masave, ndihmon të siguruarit që të njëjtat janë politikisht të pranueshme dhe mund të funksionojnë efektivisht brenda kornizës komplekse shumështresore të qeverisjes në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Krijimi dhe aplikimi i mekanizmave për menaxhim të mirë dhe të përgjegjshëm luan rol të rëndësishëm në suksesishmërinë e një politike dhe masë të caktuar.
4. ***Potenciali për të ndikuar në treg:*** është një veçori e rëndësihme, nga e cila varet nëse politika dhe masa të caktuara do të pranohen dhe zbatohen nga komuniteti i biznesit, nëse ato kanë potencial për të tërhequr investime dhe për të siguruar qëndrueshmëri.

Gjatë definimit të politikave dhe masave për efikasitetin energjeetik, komunat duhet të kenë parasysh këto katër karakteristika themelore, për të siguruar që të njëjtat do të ofrojnë rezultatet e nevojshme dhe të pritshme, në një mënyrë që të jetë në përputhje me prioritetet dhe qëllimet e përcaktuara në një nivel më të lartë, dhe do të mundësojë ndikim pozitiv në sektorin e biznesit dhe zhvillimin ekonomik lokal në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

5. Praktika dhe shembuj të mirë të efikasitetit energjetik

Praktikat e mira për efikasitet energjetik dhe shembuj nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian mund të strukturohen si :

- *Vertikale*
  - Politika dhe masa për amvisëritë
  - Politikat dhe masat e transportit
  - Politikat dhe masat për sektorin e biznesit
- *Horizontale*
  - Politikat dhe masat për shërbimet komunale
  - Qeversije të mirë
  - Mbështetje financiare.

Figura më poshtë tregon shembuj të politikave dhe masave operacionale në secilin prej këtyre niveleve, të aplikuara në një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian.




Foto 2: Shembuj dhe praktika të mira për nxitjen e efikasitetit energjetik, nga shtete të Unionit Evropian

Në vazhdim janë disa nga praktikat dhe shembujt e mirë që mund të përdorin komunat gjatë planifikimit të masave, politikave dhe aktiviteteve për të përmirësuar efikasitetin energjetik në nivel lokal:

- Inicimi i iniciativave të detyrueshme dhe vullnetare për përmirësimin e efikasitetit energjetik të objekteve rezidenciale dhe afariste, si dhe objekteve që janë në pronësi dhe/ose menaxhohen nga ndërmarrjet publike në komunë,
- Respektimi i vazhdueshëm i kodeksve energjetike për objektet e ndërtimit, për të mundësuar ekonomizim më të mirë dhe kursim të energjisë. Ofrimi i mbështetjes për investime në ndriçim me efikasitet energjetik, shfrytëzimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, ndryshimin e dyerve dhe dritareve nga materialet që mundësojnë kursimin e energjisë, si dhe izolimin e ndërtesave të reja.
- Inkurajimi i industrisë për të instaluar prodhim më të pastër, për të investuar në teknologji të reja prodhimi me kursime më të mëdha të energjisë, si dhe për të investuar në sisteme të konvertimit të energjisë, sisteme të përmirësuara të ngrohjes, shfrytëzimin e energjisë së mbeturinave, ndriçim efikas dhe të tjera.
- Krijimi i kushteve për të reduktuar varësinë dhe nevojën për përdorimin e mjeteve transportuese dhe stimulimin e përdorimit të transportit publik, si dhe mjeteve alternative të transportit, si biçikletat. Futja e ditëve pa makina, sigurimi i vendeve për karikimin e makinave elektrike, nxitja për ndryshime dhe futja e automjeteve efikase, si dhe masa të tjera që do të ulin ndotjen nga transporti.

Efikasiteti energjetik ka një sërë ndikimesh pozitive në cilësinë e jetës së popullatës lokale, dhe përpjekjet e vetëqeverisjes lokale për ta përmirësuar të njëjteën do të njihen dhe vlerësohen nga qytetarët.

Komunat kanë një rol kyç në promovimin dhe arritjen e efikasitetit të energjisë dhe përpjekjet dhe burimet e tyre mund t'i drejt njërës ose më tepër fushave e mëposhtme:

- ***Politikat dhe rregulloret:*** Miratimin e politikave dhe rregulloreve që do të stimulojnë dhe inkurajojnë projekte, aktivitete dhe investime për efikasitetin energjetik në qytet dhe komunë.
- ***Infrastruktura:*** Investimi në infrastrukturë si një mënyrë për të përmirësuar efikasitetin energjetik, si dhe investimi në efikasitetin energjetik në objektet e administratës lokale, si dhe objekteve të banimit.
- ***Edukimi dhe ngritja e ndërgjegjësimit***: Edukimi dhe informimi i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e efikasitetit energjetik dhe mënyrat për ta përmirësuar të njëjtën.
- ***Mbeshtetje financiare***: Mbështetje për programet dhe iniciativat për efikasitet energjetik, të tilla si subvencionet, reduktimet e taksave dhe tarifave vendore, dhe/ose lloje të tjera stimujsh për të rritur investimet e qytetarëve dhe të biznesit në përmirësimin e efikasitetit të energjisë
- ***Partneritetet dhe bashkëpunimi:*** Bashkëpunimi me bizneset lokale, organizatat qytetare dhe institucionet akademike për projekte dhe iniciativa të përbashkëta në lidhje me efikasitetin energjetik.
- ***Prokurimi i gjelbër***: Futja e kritereve "të gjelbra" për furnitorët dhe prokurimet publike të realizuara nga komuna.
- ***Menaxhimi dhe riciklimi i mbetjeve:*** Përmirësimi i praktikave të menaxhimit të mbetjeve dhe riciklimit të mbetjeve në komuna, me synim kursimin e energjisë dhe burimeve.
- ***Integrimi i efikasitetit energjetik në planifikimin urban:*** Përfshirja e parimeve të efikasitetit energjetik në planifikimin dhe ndërtimet në komunë.

Siç mundë të shihet, komunat luajnë një rol vendimtar në promovimin dhe arritjen e efikasitetit energjetik. Përmes veprimeve dhe mbështetjes së tyre, komunat mund të përmirësojnë cilësinë e jetës

së qytetarëve, të ulin kostot dhe të kontribuojnë në mbrojtjen më të mirë të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Aneks 1 –Lista e dokumenteve dhe informatave të përdorura për përpunimin e analizës

Nr.	Emri i dokumentit	Burimi
1.	Ligji për ratifikimin e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike	http://www.slvesnik.com.mk/Issues/EEFA8F21315F435FAFDBBE71A50FD800.pdf
2.	Ligji për ratifikimit e Protokollit të Kiotos	https://unfccc.int/process-and-meetings/the-kyoto-protocol/what-is-the-kyoto-protocol/kyoto-protocol-targets-for-the-first-commitment-period
3.	Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit	https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement
4.	Ligji për ratifikimin e Amandamentit të Dohas	https://unfccc.int/process/the-kyoto-protocol/the-doha-amendment
5.	Ligji për ratifikimin e amandamentit të Kigalit	https://www.unido.org/news/climate-action-first-kigali-implementation-plan-approved-courtesy-unido
6.	Ligji për Efikasitet Energjetik	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20energetska%20efikasnost.pdf
7.	Rregullore për etiketimin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet që përdorin energji	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%BD%D0%B8%D0%BA%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%BE%D0%B7%D0%BD%D0%B0%D1%87%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9F%D0%9A%D0%9A%D0%952534fc006a.pdf
8.	Rregullore për ndryshimin e rregullores për karakteristikat energjetike të ndërtesave	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Izmena%20na%20pravilnik%20za%20EK%20na%20zgradi99f970c0.pdf
9.	Rregullore për kontrollin e energjisë	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Pravilnik%20EK.pdf
10.	Urdhëri për eko dizajnin e produkteve	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/%D0%A3%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B1%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B5%D0%BA%D0%BE%20%D0%B4%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%98%D0%BDDC944DAD77B.pdf
11.	Strategjia afatgjatë për veprimin klimatik me Planin akcionar	https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/b20b2a9a259a2a2c8c10f977840706563bcaeb8791302106f90cb3334c840343.pdf
12.	Strategjia për promovimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/STRATEGIJA_ZA_UNAPREDUVAWE_NA_ENERGETSKATA_EFIKASNOST_VO_REPUBLIKA_MAKEDONIJA_DO_2020_GODINA.pdf
13.	Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040	https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/a8a2f3e83c25def6125000ffe8c549340c9bb9ab729a7d45bb84af56ce0818e0.pdf

Nr.	Emri i dokumentit	Burimi
14.	Plani i tretë akcionar për efiçikasitet energjetik i Republikës së Maqedonisë për periudhën 2016-2018	https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Tret%20NEEAP_V02%20(MKD).pdf
15.	Strategjia për zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 - 2031	https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/640268ee13dea6febd5cd202fbc7cf8b2e3d89bda2a9e814fa443ed30692e459.pdf
16.	Programi për efikasitet energjetik i komunës së Strugës për vitin 2019	http://www.struga.gov.mk/wp-content/uploads/2019/10/SL.GLASNIK-br.-9-03.06.2019.pdf
17.	Programi për efikasitet energjetik të komunës së Berovës 2019-2021	https://berovo.gov.mk/wp-content/uploads/2020/12/Programa-za-energetska-efikasnost-2019-2021.pdf
18.	Programi për efikasitet energjetik të komunës së Berovës për vitin 2022	https://berovo.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Programa-za-energetska-efikasnost-2022-1.pdf
19.	Analiza e programeve lokale për efikasitet energjetik në Maqedoni - situatat, sfidat, zgjidhjet	https://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2015/07/Analiza-analaitika.pdf
20.	Best Policy Practices for Promoting Energy Efficiency	https://unece.org/DAM/energy/se/pdfs/geee/pub/Promoting_EE_ECE_ENERGY_100_Rev.1_pdf_web.pdf
21.	Effective information measures to promote energy use reduction in EU member states	http://publications.europa.eu/resource/cellar/05ffd175-f97e-4237-9061-8f9689298dff.0001.03/DOC_1`
22.	Energy Efficiency Policies for local Governments	https://www.aceee.org/files/pdf/fact-sheet/local-govt-ee-policy.pdf
23.	Energy Efficiency for Low-Income Households	https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/595339/IPOL_STU(2016)595339_EN.pdf
24.	Energy Efficiency in Government Operations and Facilities	https://www.epa.gov/statelocalenergy/local-topics-energy-efficiency-government-operations-and-facilities
25.	Ndryshimet klimatike – Korniza ligjore, strategjike dhe institucionale	https://klimatskipromeni.mk/article/249
26.	Raport - Pasqyrë e gjendjes së objekteve publike të menaxhuara nga komuna e Pehçevës dhe kategorizimi i objekteve sipas efikasitetit energjetik, llojit të ngrohjes dhe shpenzimeve	Проект за енергетско-ефикасни општини
27.	Raport - Pasqyrë e gjendjes së objekteve publike të menaxhuara nga komuna e Berovës dhe kategorizimi i objekteve sipas efikasitetit energjetik, llojit të ngrohjes dhe shpenzimeve	Проект за енергетско-ефикасни општини
28.	Raport për gjendjen e objekteve publike të menaxhuara nga komuna e Strugës dhe Dibrës dhe kategorizimi i objekteve sipas efikasitetit energjetik, llojit të ngrohjes dhe shpenzimeve për ngrohje	Проект за енергетско-ефикасни општини

Nr.	Emri i dokumentit	Burimi
29.	Raport përmbledhës për gjendjen e objekteve publike të menaxhuara nga komunat e Strugës, Dibrës, Berovës dhe Pehçevës dhe kategorizimi i objekteve sipas efikasitetit energjetik	Проект за енергетско-ефикасни општини
30.	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale	https://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_lokalnata_samouprava.pdf
31.	Enti Shtetëror për Statistik	Stat.gov.mk

Tabela 3: Literatura e shfrytëzuar dhe burimet e të dhënave

Aneks 2 – Rezyme e masave të efikasitetit energjetik në sektorët e konsumit final të energjisë [2]

Nr.	Titulli i masës për efikasitetit energjetik	Organi zbatues
1.	Zbatimi i Rregullores për karakteristikat energjetike të ndërtesave	Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, komunat dhe të gjithë qytetarët
2.	Inspektime të kaldajave/sistemeve të kondicionerëve	Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë dhe kontrollorët e energjisë
3.	Rikonstruksioni i objekteve ekzistuese të banimit	Sektori privat, donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
4.	Shënimi i aparateve elektrike dhe pajisjeve	Ministria e Ekonomisë, prodhuesit dhe distributorët/furnizuesit e produkteve të energjisë dhe pajisjeve elektroshtëpiake
5.	Program promovues për aplikim më të gjerë të kolektorëve termikë diellorë	Ministria e Ekonomisë dhe sektori privat
6.	Fushatat informative dhe rrjetet e qendrave informative për efikasitet energjetik	Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë dhe furnizuesit e energjisë
7.	Përdorimi i sobave efikase me dru	Qeveria, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, prodhuesit dhe distributorët/furnizuesit e produkteve energjetike dhe pajisjeve shtëpiake
8.	Programi nacional për Efikasitet Energjetik të Ndërtesave Publike: Rikonstruimi i Ndërtesave Publike Ekzistuese	Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Fondi për Efikasitet Energjetik,ndërmarrjet publike
9.	Menaxhimi i energjisë	Ministria e Ekonomisë, subjekte nga sektori publik
10.	Ndriçimi i rrugëve komunale	Vetëqeverisja lokale komunale

[2] Burimi: Plani i tretë aksionar për efikasitet energjetik të Republikës së Maqedonisë, për periudhën 2016-2018 (https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Tret%20NEEAP_V02%20(MKD).pdf)

Nr.	Titulli i masës për efikasitetit energjetik	Organi zbatues
11.	Aplikim më i gjerë i energjisë së rinovueshme (energjia diellore, biomasa)	Ministria e Ekonomisë, vetëqeverisja lokale komunale, administrata shtetërore dhe subjektet nga sektori publik
12.	Prokurime të “gjelbërta”.	Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë dhe Byroja për Furnizime Publike
13.	Rehabilitimi i sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	Vetëqeverisja lokale komunale dhe sektori privat
14.	Rikonstruksioni i objekteve ekzistuese komerciale	Sektori privat
15.	Menaxhimi i energjisë	Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë dhe sektori privat
16.	Zbatim më i gjerë i energjisë së rinovueshme	Ministria e Ekonomisë, Sektorit Privat dhe Institucionet Financiare
17.	Përmirësimi i performancës së proceseve	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Ekonomisë
18.	PROJEKTI PMIDEE: Menaxhimi i Energjisë	Sektori privat, Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë
19.	Implementimi i motorëve efikas elektrik	Sektori privat, Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë
20.	Shfrytëzimi i ngrohjes nga mbeturinat	Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori Privat
21.	PROJEKTI KOGEN: Prodhim i kombinuar	Sektori privat, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë
22.	Shpërndarësit e nxehtësisë	Furnizuesit me energji termike dhe Komisioni Rregullativ i Energjisë
23.	Rrjetet inteligjente	Furnizuesit me energji dhe furnizuesit me energji termale
24.	Rikonstruksioni i parkut të automjeteve rrugore në nivel nacional	Enti Shtetëror i Statistikave, Sektori Privat, Subjektet e Sektorit Publik, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Vetëqeverisja Lokale Komunale, Sektori joqeveritar
25.	Promovimi i sistemeve të qëndrueshme të transportit në zonat urbane	Pushteti vendor komunal, agjencitë e transportit, organizatat joqeveritare, mediat
26.	Ditët pa automjete	Administrata Shtetërore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe qytetarët/shoferët
27.	Promovimi i përdorimit më të madh të hekurudhave	Administrata Shtetërore, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Hekurudhat e Maqedonisë - Transport.
28.	Subvencionet financiare	/
29.	EE në arsim, kërkim dhe shkencë	/
30.	Tarifat preferenciale	/
31.	Linjat kreditore	/

Tabela 4: Reyzme e masave për efikasitet energjetik

Aneks 3 – Taksonomia e karakteristikave për planifikimin e masave dhe politikave efikase dhe efektive për efikasitet energjetik

Kjo taksonomi karakteristikash përcakton një sërë cilësish që do të ndihmonin komunat dhe do të lehtësonin identifikimin sistematik të politikave dhe masave specifike për efikasitet energjetik.

Renditja e dhënë për secilën karakteristikë tregon se si vlerësohet ajo, domethënë, karakteristikat që u është caktuar një vlerë më e lartë janë të dobishme për identifikimin e politikave me efektivitet dhe efikasitet të lartë, ndërsa ato me një vlerë më të ulët, megjithëse mund të jenë të rëndësishme, janë ende më pak të dobishme.

Karakteristikat e politikave	Cilësitë dhe karakteristikat kryesore	Rëndësia për zhvillimin e politikave dhe masave	Rëndësia
Придобивки Potenciali për të reduktuar kërkesën e lartë për energji dhe shumë përfitime të rëndësishme	Efikasiteti, reduktimi i ndikimit të energjisë, përfitime të shumëfishta: monetare, sociale dhe shëndetësore	Kjo veçori tregon se cilat politika dhe masa do të kenë ndikimin më të madh. (Rezultatet ndikohen nga konteksti dhe zbatimi lokal)	E lartë
Komplementariteti, sinergjia dhe integrimi	Politikat dhe masat që plotësohen dhe integrohen mirë me politikat dhe angazhimet ncionale dhe kontribuojnë në mënyrë strategjike në realizimin e tyre	Përfitimet nga politikat dhe masat individuale rriten ndjeshëm nëse ato janë të integruara dhe komplementare me politikat dhe masat rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare.	E lartë
Përshtatshmëria, qeverisja dhe përgjegjësia	Qeveria, komunat, biznesi dhe qytetarët	Politikat dhe masat duhet të përshtaten me nevojat, kërkesat dhe pritshmëritë dhe të motivojnë palët e ndryshme të interesit. Ofron udhëzime se ku është "fshehur" përgjegjësia për sigurimin dhe shpërndarjen/implementimin e resureseve.	E lartë
	Prioriteti dhe urgjenca. Disa politika dhe masa u paraprijnë të tjerave.	Kjo veçori është specifike për tregje të veçanta dhe nuk është e rëndësishme në kushte dhe kontekst të përgjithshëm.	
Shitjet dhe ndikimi i tregut	Programe që kanë një ndikim të lartë në transformimin e tregut dhe aftësi të provuar për të motivuar përdoruesit	Politika që mundë lehtë të promovohen dhe janë efektive në bindjen e përdoruesve për të marrë vendime me efikasitet energjetik që kanë ndikim dhe nxisin investimet	E lartë

Karakteristikat e politikave	Cilësitë dhe karakteristikat kryesore	Rëndësia për zhvillimin e politikave dhe masave	Rëndësia
Mbështetje qeveritare/vendore që do të stimulojë sektorin e biznesit	NPP, ndërmarrje sociale etj.	Mbështetja e sektorit privat është e rëndësishme dhe duhet të inkurajohet bashkëpunimi dhe financimi nga sektori i biznesit.	E lartë
Fuqizimi i qytetarëve	Grupet e interesit, iniciativat lokale	Pranimi, Legjitimiteti, Thjeshtësia dhe lehtësia e zbatimit janë të gjitha karakteristika të rëndësishme për transformimin e tregut për përdoruesit.	E lartë
Potenciali për inovacion teknik dhe organizativ	Shfrytëzimi i nevojës për të zhvilluar produkte dhe shërbime konkurruese	Hipoteza e Porterit – politikat që ndihmojnë në zhvillimin e avantazhit konkurrues janë kyçe për transformimin e tregut dhe parqesin një mundësi të shkëlqyer	E lartë
Të përkohshme– koha për të ndikuar në treg	Koha për të ndikuar në treg mund të jetë e rëndësishëm për teknologjitë e energjisë me një cikël të shkurtër jete dhe aftësi për të dhënë rezultate herët.	Pas vendosjes së politikave, vlerësimi dhe rishikimi rutinë duhet t'i përgjigjet dinamikës së tregut.	E mesme
Kompleksiteti i politikave	Disa politika kanë një proces intensiv për zhvillimin e rezultateve, p.sh. Janë të nevojshme standarde, konsultime dhe kohë pë zbatim	Kompleksiteti menaxhohet dhe mund të “tregtohet” me të për sa i përket shpejtësisë dhe kostos, pra të zgjedhësh një zgjidhje më komplekse në vend të një zgjidhjeje të shtrenjtë dhe të shpejtë.	E ulët
Korniz sektoriale	Shërbimet ndërsektoriale, komunale, transporti, industria, MPS, amvisritë, shërbimet tregtare etj.	Ndihmon në zhvillimin e një ekuilibri midis sektorët dhe të sigurojë përfshirjen e sektorëve kyç si infrastruktura dhe shërbimet komunale. Përkufizimet sektoriale të planifikuara keq mund të kufizojnë mbulimin.	E ulët

Karakteristikat e politikave	Cilësitë dhe karakteristikat kryesore	Rëndësia për zhvillimin e politikave dhe masave	Rëndësia
Mekanizmat kryesorë institucionalë ose bazë të politikave	Mekanizmat politikë mund të ndahen në: detyrues (standarde të detyrueshme ose normative); ekonomike (p.sh. lehtësime tatimore); marketingu dhe komunikimi dhe (p.sh. etiketimi).	Paketat e politikave që aplikojnë mekanizma të ndryshëm mund të jenë reciprokisht përforcuese dhe sinergjike, por përdorimi i një mekanizmi të veçantë nuk garanton efektivitet.	E ulët
Qëllimet dhe potencialet	Objektivat kombëtare për efikasitet energjetik, objektivat sektoriale dhe operacionale (p.sh. (kWh/m2 -vit)	Të dobishme për kyçjen e aktorëve të ndryshëm, duke krijuar një ndjenjë rëndësie, qëllimi dhe përkushtimi	E mesme
Implementimi / Zbatueshmëria	Strategjitë nacionale, hartimi i politikave, zbatimi, pajtueshmëria, menaxhimi dhe evaluimi	Këto janë tipare themelore dhe universale në hartimin e politikave	E ulët

Tabela 5: Karakteristikat për krijimin e politikave dhe masave efektive dhe efikase për efikasitet energjetik [3]

[3] I adoptuar nga UNECE – Best Policy Practices for Promoting Energy Efficiency (Second edition) - https://unece.org/DAM/energy/se/pdfs/geee/pub/Promoting_EE_ECE_ENERGY_100_Rev.1_pdf_web.pdf